

# **FEDERATA E PINGPONGUT E KOSOVËS**

## **RREGULLORE** **PËR HARTIMIN E RANGLISTËS SË FEDERATËS SË PINGPONGUT TË** **KOSOVËS**

Prishtinë 2019

**RREGULLORE**  
**PËR HARTIMIN E RANGLISTËS SË FEDERATËS SË PINGPONGUT TË**  
**KOSOVËS**

Neni 1.

Me këtë Rregullore vërtetohet mënyra e vlerësimit të rezultateve të arritura në garat e pingpongut, nga e cila del edhe vlerësimi i suksesshmërisë së përgjithshme të garuesve në formë të ranglistës.

Neni 2.

Suksesshmëria e tërësishme e garave vërtetohet në fund të stinorit garues-rangimi për tërë vitin. Po ashtu vërtetohet edhe rangimi aktual pas çdo gare që pikëzohet gjatë stinorit garues.

Neni 3.

Ranglistat bëhen për të gjitha kategoritë, seniorë, seniore, U21, juniorë, juniore, kadetë kadete, minikadetë dhe minikadete. Me rastin e vërtetimit të pozitës në ranglistë merren parasysh vetëm rezultatet e arritura në kategorinë e caktuar.

Neni 4.

Në fillim të stinorit garues, Komisioni profesional i FPPK-së përcakton garat të cilat do të pikëzohen për ranglistë në stinorin vijues.

Neni 5.

Vlefshmëria e rezultateve sportive shprehet në pikë. Pikët ndahen në bazë të fitoreve individuale, si dhe për plasmanin e arritur, sipas kriterëve të vërtetuara me këtë Rregullore.

Neni 6.

Ranglistat, sipas të cilave pikëzohen fitoret vetjake, i renditin lojtarët në shtatë kategori:

Kategoria I	vendi 1-2 në ranglistën e FPPK-së
Kategoria II	vendi 3-4
Kategoria III	vendi 5-8.
Kategoria IV	vendi 9-16
Kategoria V	vendi 17-32.
Kategoria VI	vendi 33-64.
Kategoria VII	të tjerët.

Për lojtarët e huaj të cilët luajnë në klubet tona, si dhe për lojtarët tanë që luajnë në klubet e huaja, rangimin e caktojnë trajnerët e përzgjedhjeve.

Neni 7.

Ranglistat e FPPK-së bëhen vetëm për lojtarët dhe lojtaret që janë të regjistruara në FPPK.

#### Neni 8.

**Vërejtje:** Neni 8 **nuk** do të aplikohet menjëherë për shkak të mungesës së programit përkatës për momentin. Ky nen do të shqyrtohet nga Kuvendi në baza vjetore dhe Kuvendi do të marrë vendim të veçantë për hyrjen në fuqi të tij. Mbetet obligim i FPPK që deri atëherë të sigurojnë një program që do të mundësonte llogaritjen e ranglistës së më të përafërta me këto nene.

Në të gjitha garat pikëzuese, përveç pikëve që fitohen sipas tabelës 1 e cila është paraqitur në fund të kësaj rregulloreje, lojtarët për çdo fitore ndaj lojtarit të

Kategoria I	fitojnë 25 pikë
Kategoria II	fitojnë 20 pikë
Kategoria III	fitojnë 15 pikë
Kategoria IV	fitojnë 10 pikë
Kategoria V	fitojnë 05 pikë
Kategoria VI	fitojnë 03 pikë.
Kategoria VII	fitojnë 01 pikë

#### Neni 9.

Nëse në një garë në konkurrencën e meshkujve paraqiten më pak se 32 pjesëmarrës, për plasman nën vendin e 16-të lojtarët fitojnë pikë në lartësi prej 50%. Në konkurrencën e femrave nëse paraqiten më pak se 16 pjesëmarrës për plasman nën vendin 8 lojtaret fitojnë pikë në lartësi prej 50%.

Nëse garuesi e fiton lojën për shkak të mungesës së kundërshtarit, ai i fiton 100% të pikëve të parapara sipas tabelës 2, për atë nivel në rast se pëson humbje në nivelin tjetër

#### Neni 10.

Pikët e fituara në kategorinë më të lartë nuk vlejnë edhe për kategorinë më të ulët, edhe anasjelltas.

#### Neni 11.

Garat të cilat pikëzohen për ranglistë në kategorinë e seniorëve-eve, juniorëve-eve dhe kadetëve-eve janë:

- Kampionati individual i Kosovës
- Turnetë e pranuar dhe mbështetura nga FPPK
- Turnetë e ftuara
- Top- turnetë

#### Neni 12.

Lojtarit të përzgjedhur i takojnë pikët mbrojtëse nëse ai nuk paraqitet në garë për shkak të pjesëmarrjes në kombëtare. Në këto raste lojtarit i takojnë pikët sipas tabelës 1.

Tabela e pikëzimit për pikët mbrojtëse  
Tabela 1

Pjesëmarrja	1 fitore	2 fitore	3 fitore	4 fitore	5 fitore	6 fitore	7 fitore	8 fitore	9 fitore	10 fitore
<i>R</i>	<i>R1</i>	<i>R2</i>	<i>R3</i>	<i>R4</i>	<i>R5</i>	<i>R6</i>	<i>R7</i>	<i>R8</i>	<i>R9</i>	<i>R10</i>
<i>Pike</i>	<i>Pike</i>	<i>Pike</i>	<i>Pike</i>	<i>Pike</i>	<i>Pike</i>	<i>Pike</i>	<i>Pike</i>	<i>Pike</i>	<i>Pike</i>	<i>Pike</i>
<b>150</b>	<b>175</b>	<b>200</b>	<b>225</b>	<b>250</b>	<b>275</b>	<b>300</b>	<b>325</b>	<b>350</b>	<b>375</b>	<b>400</b>

Neni 13.

Nëse lojtarët në turne nuk mund të fitojnë asnjë ndeshje në grupe do të fitojnë 3 pikë për pjesëmarrje. (P) Lojtarët që fitojnë ndonjë lojë në grup, po jo mjaftueshëm për të kaluar grupin fitojnë 5 pikë për fitore në grup (FG).

Neni 14.

Me propozimin e Komisionit profesional, ndryshimet dhe plotësimet e kësaj Rregulloreje i bënë Bordi i FPPK-së.

Neni 15.

Tabela për pikëzimin nga turnetë  
Tabela 2

TURNET		Vendi	Vendi	Vendi	Vendi	Vendi	Vendi	Vendi	Vendi	Vendi	Vendi
		1	2	03-4	5-8	9-16	17-32	33-64	65-128	FG	P
		<i>Pike</i>	<i>Pike</i>	<i>Pike</i>	<i>Pike</i>	<i>Pike</i>	<i>Pike</i>	<i>Pike</i>	<i>Pike</i>	<i>Pike</i>	<i>Pike</i>
1	<i>Turnetë e që shpërblehen nga FPPK-ja<sup>1</sup></i>	250	200	150	120	80	40	20	10	5	3
2	<i>Turnetë tjera</i>	200	150	120	80	40	20	10	5	5	3
3	<i>Turnet "TOP 8" dhe "TOP 12"</i>	1	2	3	4	5	6	7	8		
		250	200	150	120	100	90	70	60		
		9	10	11	12						
		50	40	30	20						

Tabela për pikëzim nga garat ekipore  
Tabela 3

Kategoria	Fitore	Humbje
Superliga	12	4
Liga e pare	6	2
Liga e juniorve	6	2
Liga U21	12	4

Neni 16.

Ndryshimet e kësaj Rregulloreje janë miratuar në mbledhjen e Kuvendit të FPPK-së të mbajtur më 09.02.2019 dhe hyn në fuqi menjëherë.

Kryetari i FPPK-së

Nehat Çitaku

